



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 691/ 23 prot

Datë 27/05/2024

V E N D I M

Nr. 571/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtare
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27/05/2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “*Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre*”, me fond limit: **26,299,000** (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK me NIPT L51819005Q dhe me adresë Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Kashar/Tiranë.

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK me NIPT L52122014L dhe me adresë Ish blloku I Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra, Tiranë

- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me adresë “Rruga e Dibrës” Nr.359/1, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Adel CO” SHPK me NIPT L22117021M dhe me adresë, FERRAJ, Rr. “Myslym Keta”, Ish Rezervat e Shtetit, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.
- I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 06.02.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit: 26,299,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2. Në datën 28.02.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 08.03.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave, përkatësisht:

1. “ADEL CO” SHPK	19,748,000.00 lekë,	kualifikuar
2. “ALBDESIGN PSP” SHPK	19,890,000.00 lekë,	kualifikuar
3. “INPRESS” SHPK	21,879,000.00 lekë,	kualifikuar
4. “DynamicX Group” SHPK	24,250,000.00 lekë,	skualifikuar
5. “KRISTALINA.KH” SHPK	25,000,000.00 lekë,	skualifikuar

II.4. Në datën 18.03.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 16, datë 25.03.2024.

II.5. Në datën 25.03.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar formulari i ankesës me nr. Protokollit 691/2024 datë 25.03.2024 e operatorit ekonomik “**ALBDESIGN PSP**” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Adel CO” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 691/2 prot., datë 26.03.2024 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “ALBDESIGN PSP”

SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Adel CO” SHPK, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

- *“...nuk përmbush kriterin e mësipërm pasi nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Në rastin konkret kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK për përmbushjen e kërkesës së mësipërme nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributor për të gjithë mallrat objekt prokurimi por ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori vetëm për mallrat “Pulla kontrolli me elementë sigurie, dhe numër serial progresiv” dhe nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributor në mënyrë të qartë dhe të specifikuar në autorizim për mallrat “Shirita printimi për printer termik SQUIX ose ekuivalent”, “Rulona mbledhës për pullat” dhe “Rulona mbledhës për shirita printimi”, pavarësisht faktit se në dokumentat e tenderit parashikohet shprehimisht që duhet të kemi të bëjmë me një prodhues të mirëfilltë për secilin prej mallrave objekt prokurimi. Akoma më tej, edhe nëse operatori ekonomik “Adel Co” SHPK pretendon se ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për të gjithë mallrat objekt prokurimi kërkojmë të verifikohet nëse prodhuesi/distributori ushtron veprimtarië specifike për prodhimin ose distribucionin specifik për të gjithë këto mallra, pasi kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar vetëm një autorizim prodhuesi/distributori duke pretenduar që ky i fundit përfshin në veprimtarinë e tij prodhimin/distribucionin për të gjithë mallrat objekt prokurimi por në praktikë kemi dyshime të arsyeshme se kjo gjë nuk është e vërtetë pasi prodhuesi/distributori ushtron veprimtarinë e tij vetëm për pulla kontrolli me elementë sigurie, dhe numër serial progresiv dhe rrjedhimisht operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk e përmbush këtë kriter dhe duhet të ishte skualifikuar”,*
- *“...kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk përmbush kërkesën e mësipërme pasi mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”. Për këtë arsye kërkojmë të verifikohet përmbushja e specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit për mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK. Gjithashtu, në lidhje me mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK jemi të paqartë se çfarë testimi ka kryer autoriteti kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë e mostrave të dorëzuara me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit”,*
- *“...kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk ka dorëzuar në SPE shtojcën 4 “Lista e informacionit konfidencial” ose edhe nëse e ka dorëzuar këtë deklartatë ky operator ekonomik nuk ka plotësuar listën e informacionit konfidencial për mostrat që ka dorëzuar”.*

II.5.2 Më datë 29.03.2024, operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Adel CO” SHPK ka depozituar Formularin e paraqitjes së dokumenteve me nr.36 prot., datë 28.03.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 961/3 prot., datë 29.03.2024.

II.5.3. Me shkresën nr. 691/4 prot., datë 11.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor, për të dorëzuar mostrat e e paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.5.4. Me anë të shkresës nr. 485/44 prot., datë 16.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/5 prot., datë 16.04.2024 me lëndë “Kthim - përgjigje”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar mostrat, si dhe informacion mbi procesin e dorëzimit të mostrave në autoritet kontraktor.

II.5.5. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 691/6 prot., datë 22.04.2024, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5.6. Me shkresën nr. 691/7 prot., datë 24.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020, ka vënë në dijeni të gjitha palëve të mësipërme, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.6. Në datën 25.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2024/3916 dhe me nr. 692/2024 prot., datë 25.03.2024, e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit: **26,299,000** (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar. Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues, pretendon, se nuk përmbushen nga “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 692/2 prot., datë

26.03.2024 lidhur me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

“KVO e AK ka kualifikuar në mënyrë të gabuar OE Adel Co shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsyet e mëposhtme:

Së Pari, Në kundërshtim me pikën 2.3/a. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Adel Co shpk. nuk ka furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për secilin artikull / mall të kërkuar në DST.....

.....NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP punë / furnizime të ngjashme në total në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh (40% të vlerës së fondit limit), dhe në proporcion me ofertën e parqitur prej tij për zërat e secilit prej artikujve / mallrave (40% të vlerës së fondit limit për secilin artikull / mall të ofertuar) të kërkuara në DST;

NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar nga DST dhe sipas përcaktimeve të specifikuara në DST, për të vërtetuar realizimin e punëve të ngjashme (në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh), dhe në proporcion me ofertën e parqitur prej tij për artikujt / mallrat, e kërkuar në këtë procedurë prokuruese.....Rrjedhimisht, kemi bindjen se OE Adel Co shpk., nuk ka kryer punë dhe shërbime të ngjashme gjatë 3-viteve të fundit për asnjë prej mallrave / artikujve që do të prokurohen, si dhe, gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik për të provuar / vërtetuar realizimin e punëve dhe shërbimeve të ngjashme,... dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP.

Së Dytë, Ne kemi bindjen, që OE Adel Co shpk., në kundërshtim me pikën 2.3/c) “Kapacitetet teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrën “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostra “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” e paraqitura nga OE Adel Co shpk., NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në Shtojcën 7 të Kriteret e veçanta të kualifikimit” - të Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6, të DST, përse i përket:

- i. Peshës së Etiketës të mostrave të dorëzuara;
- ii. Spesorit të Etiketës të mostrave të dorëzuara;
- iii. Peshës së Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara;
- iv. Spesorit të Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara.

Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimi të mostrës "Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie" të dorëzuar nga OE Adel Co shpk. nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunueshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5, të DST. Rrjedhimisht, OE Adel Co shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.6. "Kapaciteti teknik", të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

3. Së Treti, Në kundërshtim me pikën 2.3./b) "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST.....

Për sa mësipër, ne shprehim bindjen tonë, që: OE Adel Co shpk. NUK ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik "...autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për secilin dhe të gjithë artikujt / mallrat e përcaktuar në DST dhe të ofertuar, në origjinal ose kopje të përkthyer dhe njesuar me origjinalin.

Konkretisht, OE Adel Co shpk. NUK ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik "...autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për:

? Artikullin / mallin - "Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie"

? Artikullin / mallin - "Shirita printimi për printer termik SQUIX ose ekuivalent"

? Artikullin / mallin - "Rulona mbledhës për pullat"

? Artikullin / mallin - "Rulona mbledhës për shirita printimi"

Për sa mësipër, OE Adel Co shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3./b) "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST.

II. Përsa i përket vendimit të KVO të AK, për Kualifikimin e **Operatorit Ekonomik "Albdesign PSP" shpk.**, Ju paraqesim kundërshtitë tona si vijon:

Së Pari, Ne jemi të bindur se Operatori ekonomik "Albdesign PSP", në kundërshtim me:

...Operatori ekonomik Albdesign PSP shpk. nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetdeklarimit në pikën ku citon "Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. "

për të cilën duhet të

përcaktonte se adresa e ueb-it është www.app.gov.al dhe Autoriteti ose organi lëshues që është Buletini i Agjencisë së Prokurimit Publik. Referuar sa më sipër, operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 7 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos dhënë të dhëna që ky formular parashikon.

Së Dytë, Në kundërshtim me pikën 2.3/a. "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, Operatori ekonomik Adel Co shpk. nuk ka furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për

secilin artikull / mall të kërkuar në DST.....Rrjedhimisht, kemi bindjen se OE Albdesign PSP shpk., nuk ka kryer punë dhe shërbime të ngjashme gjatë 3-viteve të fundit për asnjë prej mallrave / artikujve që do të prokurohen, si dhe, gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik për të provuar / vërtetuar realizimin e punëve dhe shërbimeve të ngjashme,... dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP.

Së Tretë, Ne kemi bindjen, që OE Albdesign PSP shpk., në kundërshtim me pikën 2.3/c) “Kapacitetet teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrën “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.....Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostra “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” e paraqitur nga OE Albdesign PSP shpk., NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në Shtojcën 7 iKriteret e vecanta të kualifikimit” - iKapaciteti teknik”, pika 2.3.6, të DST, përsa i përket:

- i. Peshës së Etiketës të mostrave të dorëzuara;
- ii. Spesorit të Etiketës të mostrave të dorëzuara;
- iii. Peshës së Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara;
- iv. Spesorit të Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara.

Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrave të dorëzuara nga OE Albdesign PSP shpk. nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpunueshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5, të DST.

Rrjedhimisht, OE Albdesign PSP shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.c) iKapaciteti teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST.

Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik do të duhet të:

- ? Ndryshojë vendimin e marrë nga KVO e AK Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- ? Skualifikojë Operatorët Ekonomikë: 1. Adel Co shpk.; 2. Albdesign PSP shpk.;
- ? ...si dhe të shpallë fitues të procedurës së prokurimit të lartpërmendur, operatorin ekonomik “Inpress” shpk.

II.6.2. Më datë 29.03.2024, operatori ekonomik, subjekt i interesuar “Adel CO” SHPK ka depozituar Formularin e paraqitjes së argumenteve me nr. 36 prot., datë 28.03.2024, protokolluar pranë nesh me nr. 962/4 prot., datë 29.03.2024.

II.6.3. Me shkresën nr. 485/29 prot., datë 09.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 692/5 prot., datë 04.04.2024, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike online, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, duke e refuzuar atë.

II.7. Me shkresat nr. 691/ 8 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/11 prot., datë 03.05.2024 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to.

II.8. Me shkresat nr. 691/ 9 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/12 prot., datë 03.05.2024 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Laboratorit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to.

II.9. Me shkresën nr. 485/49 prot., datë 26.04.2024, protokolluar me tonën me nr. 692/10 prot., datë 29.04.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” SHPK, duke e refuzuar atë.

II.10. Me shkresën nr. 375 prot., datë 06.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/13 prot., datë 09.05.2024, Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, duke dërguar informacionin e kërkuar.

Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 691/5 prot., datë 03.05.2024 me lëndë “Rikërkesë për informacion, të drejtuar pranë zyrës tonë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumenta të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konformë standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

“Eko-Studio-Projekt” SHPK realizon matje laboratorike fizike, kimike dhe vizuale të letrës dhe kartonit bazuar në procedura dhe standarde ndërkombëtare. Për realizimin e matjeve vizuale dhe fizike laboratorit disponon një sërë pajisjesh për realizimin e cilësisë dhe vetive të letrës dhe pullave siç janë:

- *Mikroskop optik me dritë dhe mikroskop stereo, të aftë për të dhënë një zmadhim normal të paktën 100x;*
- *Reflektometër USB-1 që ka karakteristikat fotometrike i pajisur për matjen e faktorit të reflektimit blu;*
- *Lente optike LED UV 30X me dritë UV;*
- *Numurues Suntex 570;*
- *Colorimetër PCE-XXM 20 i cili përcakton ngjyrën e sipërfaqeve;*

- Kalibër dhe mikrometër për përcaktimin e përmasave;
- Pasametër për përcaktimin e trashësisë;
- Si dhe pajisje të tjera për përcaktimin e matjeve kimike dhe gravimetrike.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit pjesë e fushës së akreditimit:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
5.	<i>Bardhësia</i>	<i>CIE</i>	<i>SSH ISO 11475:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
6.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
7.	<i>Lagështia</i>	<i>1-100%</i>	<i>SSH EN ISO 287:2017</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brum Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emertimi Proves</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standarti Proves</i>	<i>Standarti Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
3.	<i>Faktori i shperndarjes se ndricimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Tejdukshmeria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>2 mg/l – 500 mg/l</i>	<i>SSH ISO 692:1982</i>	<i>ISO 186:2002</i>

Për kryerjen e testeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampionët përfaqësues. Laboratori i Eko-Studio-Projekt shpk disponon pajisje bashkëkohore dhe zbaton standarde ndërkombëtare për fiksimit dhe realizimin e testeve të përmasave. Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi per njësi në lek pa TVSH</i>	<i>Cmimi total për kampion në lekë pa TVSH</i>
1.	<i>Gramatura</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>5280</i>	<i>5280</i>
2.	<i>Përmasat</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>3360</i>	<i>3360</i>
3.	<i>Trashësia (spesori)</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>3976</i>	<i>3976</i>
4.	<i>Densiteti</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>3312</i>	<i>3312</i>
5.	<i>Bardhësia</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>4400</i>	<i>4400</i>
6.	<i>Tejdukshmëria</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>5040</i>	<i>5040</i>
7.	<i>Faktori i shpërndarjes së ndricimit (shkëlqyeshmëria)</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>4640</i>	<i>4640</i>
8.	<i>Reflektimi ne UV</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>2880</i>	<i>2880</i>
9.	<i>Ngjyra</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>4400</i>	<i>4400</i>
10.	<i>Përshkrimi fizik</i>	<i>Copë/një testim</i>	<i>1</i>	<i>4800</i>	<i>4800</i>

v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”

II.11. Në datën 10.05.2024 KPP mori vendimin nr. 477/2024 ku vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me*

specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre”, me fond limit: 26,299,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 28.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

2. Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 14.05.2024 ora 11:00.
3. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 14.05.2024 ora 11:00.
4. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 14.05.2024 ora 11:00.
5. Në datën 14.05.2024 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.
6. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
7. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.12. Në vijim të vendimit nr. 477/2024, datë 10.05.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, në mjediset e KPP-së me datë 14.05.2024, ora 11:00, u zhvillua seanca dëgjimore me prezencën e përfaqësuesve të Komisionit të Prokurimit Publik, përfaqësuesve të operatorëve ekonomike “ADEL CO” SHPK, “Inpress” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, si dhe të përfaqësuesit të autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Para nisjes së seancës dëgjimore, e cila u regjistrua në audio në sistemin e ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni iu drejtua palëve të pranishëm nëse ka kërkesa paraprake. Nuk pati kërkesa paraprake nga ana e të pranishmëve.

Komisioni i prokurimit Publik ka konstatuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit se cilët janë laboratorët e akredituar për kryerjen e shërbimit të testimit të mostrave të dorëzuara në procedurën e prokurimit objekt - ankimi dhe fushën e akreditimit të tyre. Komisioni i ka kërkuar me shkresë zyrtare dy institucioneve të akredituara të dhëna, sipas informacionit të vënë në dijeni në momentin e zhvillimit të veprimeve procedurale duke pritur në një afat të arsyeshëm të dy laboratorët për testimin e mostrave. Një prej laboratorëve ka bashkëpunuar dhe ka kthyer përgjigje mbi tarifën dhe mundësinë e tyre mbi kryerjen e testeve. Komisioni iu drejtua palëve konkretisht “ALBDESIGN PSP” SHPK dhe “INPRESS” SHPK, nëse është parapaguar nga secili në mënyrë respektive, për llogaritë të Laboratorit të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shuma prej 18,512 lekë pa TVSH për testimin e mostrave (për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori) të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK dhe “ADEL CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024.

Komisioni konstatoi, që nga ana e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK është dorëzuar mandat - pagesa nga banka e nivelit të dytë më datë 13.05.2024 për parapagim testim - mostrash, në shumën e urdhëruar. Nga ana e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK, gjithashtu u konfirmua kryerja e parapagimit sipas pikave 3 dhe 4 të dispozitivit të vendimit KPP 477/2024, datë 10.05.2024. Si fillim Komisioni ashtu siç iu informoi, ka marrë në administrim mostrat e dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt - ankimi të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor. Palët mund të jenë të lutura të shoqërojnë në vlerësimin dhe gjykimin e tyre në procesin e dorëzimit të mostrave. Në këtë seancë, u verifikuan dhe u konfirmuan mostrat e secilit operator ekonomik konkretisht “ADEL CO” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK, prezent në këtë seancë dëgjimore, në prani edhe të përfaqësuesit të autoritetit kontraktor. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, përzgjedhi një nga mostrat e tij (“Etiketa” dhe “Letra mbajtëse ku vendosen pullat”), për t’u dërguar për testim, pranë Laboratorit të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK, përzgjedhi një nga mostrat e tij (“Etiketa” dhe “Letra mbajtëse ku vendosen pullat”), për t’u dërguar për testim, pranë Laboratorit të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK. Nuk pati kundërshtim nga palët në proces.

II.13. Më datë 14.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 691/17 prot., datë 14.05.2024, mandat - pagesa e kryer nga operatori ekonomik ankimes “ALBDESIGN PSP” SHPK në favor të Laboratorit të “Eko-Studio Projekt” SHPK, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 477/2024, datë 10.05.2024.

II. 14. Me shkresën nr. 485/54 prot., datë 13.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/18 prot., datë 15.05.2024, autoriteti kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, ka depozituar informacion mbi vendimin 477/2024.

II.15. Me shkresat me nr. 402 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/19 prot., datë 24.05.2024 dhe me nr. 403 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonën me nr.

691/20 prot., datë 24.05.2024, me objekt “Raporti i testimit” të Laboratorit të “Eko-Studio Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

- ❖ Raport - Testimi Nr. 402 dt. 21.05.2024, “*Etiketa*” për specifikimet peshën dhe spesori, “*Letra mbajtëse ku vendosen pullat*” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.560	61.547	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	56	µm

- ❖ Raport Testimi Nr. 403 dt.21.05.2024, “*Etiketa*” për specifikimet peshën dhe spesori, “*Letra mbajtëse ku vendosen pullat*” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.16	61.253	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	55	µm

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK për kualifikimin e operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi me argumentin se: “...nuk përmbush kriterin e mësipërm pasi nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Në rastin konkret kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK për përmbushjen e kërkesës së mësipërme nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributor për të gjithë mallrat objekt prokurimi por ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori vetëm për mallrat “Pulla kontrolli me elementë sigurie, dhe numër serial progresiv” dhe nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributor në mënyrë të qartë dhe të specifikuar në autorizim për mallrat “Shirita printimi për printer termik SQUIX ose ekuivalent”, “Rulona mbledhës për pullat” dhe “Rulona mbledhës për shirita printimi”, pavarësisht faktit se në dokumentat e tenderit parashikohet shprehimisht që duhet të kemi të bëjmë me një prodhues të mirëfilltë për secilin prej mallrave objekt prokurimi. Akoma më tej, edhe nëse operatori ekonomik “Adel Co” SHPK pretendon se ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për të gjithë mallrat objekt prokurimi kërkojmë të verifikohet nëse prodhuesi/distributori ushtron veprimtarië specifike për prodhimin ose distribucionin specifik për të gjithë këto mallra, pasi kemi dyshime të

arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar vetëm një autorizim prodhuesi/distributori duke pretenduar që ky i fundit përfshin në veprimtarinë e tij prodhimin/distribucionin për të gjithë mallrat objekt prokurimi por në praktikë kemi dyshime të arsyeshme se kjo gjë nuk është e vërtetë pasi prodhuesi/distributori ushtron veprimtarinë e tij vetëm për pulla kontrolli me elementë sigurie, dhe numër serial progresiv dhe rrjedhimisht operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk e përmbush këtë kriter dhe duhet të ishte skualifikuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 për pika 2.3.b “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“ b) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (në rast se nuk është prodhues i miërfilltë) duhet të paraqesë **Autorizim nga Prodhuesi ose nga Distributori Zyrtar i Autorizuar nga Prodhuesi**. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, website, nëse lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “ADEL CO” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Autorizim Prodhuesi (të njësuar me origjinalin dhe të përkthyer), datë 16.02.2024, lëshuar nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H me përmbajtje si më poshtë vijon: “Nëpërmjet kësaj, Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me numër regjistri të kompanisë FN89306h) prodhues të mirënjohur dhe prestigjioz të etiketave, biletave, pullave dhe produkteve të printuara të sigurisë të Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me fabrika në Betriebsstrasse 3, A-2011 Höbersdorf, Austri, autorizon Adel Co shpk për të paraqitur një ofertë, dhe më pas për të negociuar dhe nënshkruar kontratën me institucionin tuaj sipas Specifikimeve Teknike në Dokumentet e Tenderit “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre” Nr. Reference 94529-02-05-2024 për mallrat/lëndën e parë të mësipërme të prodhuara nga ne. Ne japim garancinë tonë të plotë se do të prodhojmë dhe furnizojmë Adel Co shpk me mallrat siç përshkruhet në specifikimet teknike të kushteve të kontratës për mallrat e ofruara për furnizim nga firma e mësipërme ndaj kësaj ftese për ofertë.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përkrahur nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e

saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet

deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi për këtë procedurë prokurimi, për tregtimin e artikujve të ofruar (Dokumentet duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara). Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, website, nëse lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetin Kontraktor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur ndër të tjera edhe Autorizim Prodhuesi (të njëshuar me origjinalin me Nr. Rep 638 datë 19.02.2024 dhe të përkthyer dhe noterizuar me Nr. Rep 637, datë 19.02.2024), datë 16.02.2024 lëshuar nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H i nënshkruar dhe i vulosur me përmbajtje si më poshtë vijon: *“Nëpërmjet kësaj, Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me numër regjistri të kompanisë FN89306h) prodhues të mirënjohur dhe prestigjioz të etiketave, biletave, pullave dhe produkteve të printuara të sigurisë të Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me fabrika në Betriebsstrasse 3, A-2011 Höbersdorf, Austri, autorizon Adel Co shpk për të paraqitur një ofertë, dhe më pas për të negociuar dhe nënshkruar kontratën me institucionin tuaj sipas Specifikimeve Teknike në Dokumentet e Tenderit “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre” Nr. Reference 94529-02-05-2024 për mallrat/lëndën e parë të mësipërme të prodhuara nga ne. Ne japim garancinë tonë të plotë se do të prodhojmë dhe furnizojmë Adel Co shpk me mallrat siç përshkruhet në specifikimet teknike të kushteve të kontratës për mallrat e ofruara për furnizim nga firma e mësipërme ndaj kësaj ftese për ofertë”.*

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentin me emërtim autorizim prodhuesi lëshuar më datë 16.02.2024 nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, ku pasqyrohet kompania prodhuese dhe të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, në se lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetin Kontraktor. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.b të kriteve të veçanta të kualifikimit “kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” ShPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK për kualifikimin e operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi me argumentin se: “...kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk përmbush kërkesën e mësipërme, pasi mostrat e dorëzuara nga ky operator ekonomik nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”. Për këtë arsye kërkohet të verifikohet përmbushja e specifikimeve teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit për mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Adrel Co” SHPK. Gjithashtu, në lidhje me mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK jemi të paqartë se çfarë testimi ka kryer autoriteti kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë e mostrave të dorëzuara me specifikimet teknike të parashikuara në dokumentat e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, në pikën 2.3.c) të kriterëve teknike, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

c) *Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë mostra të mallrave objekt prokurimi - për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit.*

1. *Rulon me jo më pak se 200 pulla në rulon - 1(një) copë;*

2. *Shirit stampimi termik - 1(një) copë*

**të mjaftueshme për të realizuar stampimin e plotë të rulonit me 200 pulla;*

3. *Rulon kartoni mbledhës për pulla - 1(një) copë;*

4. *Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi - 1(një) copë.*

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat do të dorëzohen nga OE ofertues, në Zyrën e Protokollit të AKBPM, Kati i Parë, në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të futur në një zarf jo-transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e OE ofertues dhe me shënimin: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës: 21/2/2024, ora: 10.00”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kerkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.

III.2.2. Në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit është kërkuar:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj;

Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

SPECIFIKIME TEKNIKE:

- **PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

- ***Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:***

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

Përshkrimi: pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

- ***Etiketa***

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

- ***Adezivi***

Nga prapa pulla të ketë adevziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

▪ **Letra mbajtëse ku vendosen pullat**

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë **Pantone 608C** e sfumuar nga jashtë brenda.

Pulla do të përfshijë të stampuar:

- a) Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë **Blu Reflex** e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter **Times Neë Roman** (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë **Blu Reflex**.
- b) Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë **Blu Reflex** e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE** me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter **Times Neë Roman** (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë **Blu Reflex**.
- c) Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit **Times Neë Roman**, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.

- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin *MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE*, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin *AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE*, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit te ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave)

- **SHIRITA STAMPIMI TERMIK:**

Karakteristikat: Shiriti i printimit është i standartit universal ose ekuivalent i tij, i përshtatshëm për printim në letër me shtresë të shkëlqyeshme (gloss coated). Për printerat që disponojmë, shiriti termo-transfertë mund të jetë i ngjashëm me tipin ëax/resin.

Shiriti duhet të ketë: rezistencë të lartë kundrejt gërvishtjeve; tretësve të ndryshëm;

veti stampuese shumë të mira.

Densiteti optik i shiritit 0.9 në transmetim

Densiteti optik (reflektimi) 1.70 në reflektim

Ambalazhi

Shirit i stampimit të jetë i mbledhur në rulona me gjatësi minimalisht 360 m dhe gjerësi 30 mm, diametër i brendshëm i unazës së kartonit të jetë 25mm, të përdorshëm për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termike SQUIX**, të paketuara në kuti mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

- **RULONA KARTONI:**

- a) për mbledhjen e pullave, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 40mm, e përshtatshme për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termike SQUIX**;

b) për mbledhjen e shiritave të printimit, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 25mm.

Ambalazhi

Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.


Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (kuti/kolia numrin e rulonave).


Modele ilustruese të pullës dhe aksesoreve për shtypjen e tyre (foto):



Model pulle



Pulla në rulon



Pulla në shirit



Shirita stampimi termik në rulon



Shirita stampimi termik



printimit

Rulon kartoni për mbledhjen e shiritit të



Rulon kartoni për mbledhjen e pullave

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për plotësimin e kriterit për dorëzimin e mostrave nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Referuar procesverbalit të datës 28.02.2024 ora 10:00, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me administrimin e mostrave, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar në zarf me nr. Prot., 485/20 datë 28.02.2024:

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.9. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.2.10. Në nenin 36 “Specifikimet teknike”, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët,

furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.2.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.2.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” ShPK, konstatohet se

verifikimi i mostrave, nga Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, është bërë referuar specifikimeve teknike në këtë procedurë prokurimi. Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave ka hartuar Raport teknik me nr. 485/26 prot., të datës 07.03.2024, sipas së cilit është kualifikuar operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për përmbushje të specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara prej tij. Këtë vlerësim e ka dhënë Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimit teknik të tyre.

Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllimin e zbatimit të parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, duke u mbështetur në pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, kërkoi kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave *pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre* për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura të depozituar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure prokurimi. Në kushtet kur, Komisioni nuk disponon pajisjet e duhura për një ekspertizë të tillë, iu drejtua me shkresat nr. 691/ 8 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/11 prot., datë 03.05.2024, Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to. Me shkresat nr. 691/ 9 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/12 prot., datë 03.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Laboratorit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar, që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to. Me shkresën nr. 375 prot., datë 06.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/13 prot., datë 09.05.2024, Laboratori EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, ka dërguar informacionin e kërkuar.

III.2.13. Pas konfirmimit të Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik 10.05.2024 mori vendimin nr. 477/2024, ku vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit: 26,299,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.*
- 2. Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa TVSH për*

testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024, për testimin e mostrave, dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 14.05.2024 ora 11:00.

3. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brënda datës 14.05.2024 ora 11:00.
4. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa TVSH për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024, ora 11:00.
5. Në datën 14.05.2024 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.
6. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
7. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.2.14. Me shkresën me nr. 403 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/20 prot., datë 24.05.2024, me objekt “Raport - testimi” nga Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

- ❖ Raport Testimi Nr. 403 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.16	61.253	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	55	µm

Peshimi u krye me peshoren analitike elektronike KREN e tipit ABT 120-5DM e klasit të I. Kjo peshore është e kalibruar me anë të standardit ISO 45501 dhe në përputhje me rekomandimet e OIML, dhe R76-1 nga Laboratori i Masës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Marzhi i gabimit të vetë aparatit është 0.1g, gabim i pranueshëm. Kushtet e

mjedisit gjatë kryerjes së peshimit janë normale, me temperaturë 21°C, lagështu relative 51% dhe presion atmosferik 14.731psi. Mostra e parë e peshuar është e tipit etiketë e cila u shkëput mnga letra mbajtëse dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5 cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqia totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pështa mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02931g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si më poshtë:

$$\text{Masa në m}^2 = M/S \times 10000$$

Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;

S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².

Bazuar në formulën e sipërme përmendur masa letër është 78.16 g/m².

Mostra e dytë e peshuar është e tipit letër mbajtëse e etiketës e cila u shkëput nga etiketa dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqia totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pështa mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02297g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si mëposhtë:

$$\text{Masa në m}^2 = M/S \times 10000$$

Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;

S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².

Bazuar në formulën e sipërme përmendur masa letër është 61.253 g/m².

III.2.15. Referuar sa më sipër, Komisioni i prokurimit Publik vëren, se në specififikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi rezulton se:

- **PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

Përshkrimi: pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

- **Etiketa**

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pështa 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%
Opaciteti 90%
Shkëlqyeshmëria 84%
Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

▪ **Adezivi**

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

▪ **Letra mbajtëse ku vendosen pullat**

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. *I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 608C e sfumuar nga jashtë brenda.*

Pulla do të përfshijë të stampuar:

d) *Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.*

e) *Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.*

f) *Në krahu e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.*

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtëkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtëkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit të ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave).

Ndërkohë nga raport testimet e paraqitura të kryera nga laboratorit i akredituar Laboratorit “Eko-Studio Projekt” SHPK, rezultoi se mostra, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” ShPK në datën dhe orën e zhvillimit për këtë procedurë prokurimi, ka rezultuar me të dhënat teknike si më poshtë:

- ❖ Raport Testimi Nr. 403 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.16	61.253	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	55	µm

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me të drejtë ka kualifikuar operatorin ekonomik “Adel Co” ShPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht, të gjithë komponentët e kërkuar të testuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcës nr.5 “Specifikimet teknike” për “*Etiketa*” për specifikimet peshën dhe spesori, “*Letra mbajtëse ku vendosen pullat*” për specifikimet peshën dhe spesori”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Për më tepër, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka pasur reklamim nga përfaqësuesit e palëve prezente të operatorëve ekonomikë apo autoritetit kontraktor, mbi mostrën, për të cilën do të kryhej ekspertiza e kërkuar në laborator të akredituar nga ana e Komisionit. Gjithashtu, Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor, për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar raportit të testimit të kryer nga laboratorit i akredituar, gjykon, se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Adel Co” ShPK, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” ShPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK për kualifikimin e operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi me argumentin se: “...kemi dyshime të arsyeshme se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK nuk ka dorëzuar në SPE shtojcën 4 “Lista e informacionit konfidencial” ose edhe nëse e ka dorëzuar këtë deklaratë ky operator ekonomik nuk ka plotësuar listën e informacionit konfidencial për mostrat që ka dorëzuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Për mostrat që do të dorëzohen, të plotësohet dhe të paraqitet në rrugë elektronike Lista e informacionit Konfidencial sipas shtojcës 4 të DST”

III.3.2. Në shtojcën 4 “Lista e Informacionit Konfidencial”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

<i>Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial</i>	<i>Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale</i>	<i>Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni</i>	<i>Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni</i>

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

III.3.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Lista e Informacionit Konfidencial, më datë 28.02.2024, nënshkruar dhe vulosur nga administratori i subjektit, në lidhje me mostrat e dorëzuara nga ky i fundit.

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për 14 përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.3.6. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për sa i përket dorëzimit dhe plotësimit të dokumentit sipas shtojcës 4 “Lista e informacionot konfidencial”, nga ana e operatorit

ekonomik “Adel Co” SHPK, Komisioni vëren, se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në fjalë, rezulton, se janë plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas rubrikave të shtojcës nr.4. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij është plotësuar lista e informacionit konfidencial, ku ka plotësuar të dhënat që kërkohen.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALBDESIGN PSP” SHPK nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për kualifikimin e operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK, nga procedura e prokurimit objekt - shqyrtimi me argumentin se: *“KVO e AK ka kualifikuar në mënyrë të gabuar OE Adel Co shpk., në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të fushës aktualisht në fuqi, si dhe në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt ankese, për arsyet e mëposhtme: **Së Pari**, Në kundërshtim me pikën 2.3/a. “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ...Operatori ekonomik Adel Co shpk. nuk ka furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për secilin artikull / mall të kërkuar në DST.....NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP punë / furnizime të ngjashme në total në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh (40% të vlerës së fondit limit), dhe në proporcion me ofertën e paraqitur prej tij për zërat e secilit prej artikujve / mallrave (40% të vlerës së fondit limit për secilin artikull / mall të ofertuar) të kërkuara në DST; NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar nga DST dhe sipas përcaktimeve të specifikuara në DST, për të vërtetuar realizimin e punëve të ngjashme (në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh), dhe në proporcion me ofertën e paraqitur prej tij për artikujt / mallrat, e kërkuar në këtë procedurë prokuruese.....Rrjedhimisht, kemi bindjen se OE Adel Co shpk., nuk ka kryer punë dhe shërbime të ngjashme gjatë 3-viteve të fundit për asnjë prej mallrave / artikujve që do të prokurohen, si dhe, gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe teknik për të provuar / vërtetuar realizimin e punëve dhe shërbimeve të ngjashme,... dhe për këtë arsye do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 2 modifikohet kriteri 2.3.a), “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.a) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: *Shtojca 7 e DST “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, te “2. Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”:*

Ishte:

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Bëhet:

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

III.4.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë furnizimi me nr. 4077/18 prot., datë 17.05.2018 me objekt “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesorë për shtypjen e tyre për periudhën maj-qershor 2018”, lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxxxxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 6477/1 prot., datë 26.07.2018 lëshuar nga autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” për kontratën me objekt “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesorë për shtypjen e tyre për periudhën maj-qershor 2018”.

Faturë tatimore nr. 146 datë 17.05.2018 lëshura nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me vlerë xxxxx pa Tvsh.

Faturë tatimore nr. 9A datë 31.05.2018 lëshura nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me vlerë xxxxxxx pa Tvsh.

Faturë tatimore nr. 7A datë 25.05.2018 lëshura nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me vlerë xxxxx pa Tvsh.

1	Faturë tatimore nr. 146 datë 17.05.2018 lëshuar nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	xxx
2	Faturë tatimore nr. 9A datë 31.05.2018 lëshuar nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	xxxx
3	Faturë tatimore nr. 7A datë 25.05.2018 lëshuar nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	xxxxx
		xxxxxx

Kontratë furnizimi shtesë me nr. 972 prot., datë 30.01.2018 me objekt “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesorë për shtypjen e tyre” lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxxxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 6477/3 prot., datë 26.07.2018 lëshuar nga autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” për kontratën me objekt “Blerje pulla kontrolli me element sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”.

Faturë tatimore nr. 81 datë 09.03.2018 lëshura nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me vlerë xxxxxxx pa Tvsh.

Faturë tatimore nr. 4A datë 13.04.2018 lëshura nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore me vlerë xxxxxxx pa Tvsh.

1	Faturë tatimore nr. 9A datë 31.05.20218 lëshuar nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	xxxx
2	Faturë tatimore nr. 4A datë 13.04.2018 lëshuar nga Adel CO SHPK për Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	xxxxx
		xxxx

Kontratë furnizimi me nr. 843 prot., datë 06.05.2020 me objekt “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD” lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 1889/2 prot., datë 27.04.2022 lëshuar nga autoritetit kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha” për kontratën me objekt “Shërbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”.

Fatura tatimore

1	Faturë tatimore nr. 38 datë 14.05.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
2	Faturë tatimore nr. 41 datë 18.05.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
3	Faturë tatimore nr. 48 datë 04.06.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
4	Faturë tatimore nr. 51 datë 17.06.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
5	Faturë tatimore nr. 59 datë 06.07.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
6	Faturë tatimore nr. 67 datë 22.07.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjiellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx

7	Faturë tatimore nr.71 datë 06.08.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
8	Faturë tatimore nr.74 datë 17.08.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
9	Faturë tatimore nr.78 datë 08.09.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
10	Faturë tatimore nr.83 datë 18.09.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
11	Faturë tatimore nr.93 datë 12.10.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
12	Faturë tatimore nr.97 datë 26.10.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
13	Faturë tatimore nr.104 datë 11.11.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
14	Faturë tatimore nr.114 datë 03.12.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
15	Faturë tatimore nr.116 datë 11.12.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
16	Faturë tatimore nr.119 datë 18.12.2020 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
17	Faturë tatimore nr.04 datë 20.01.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
18	Faturë tatimore nr.09 datë 04.02.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
19	Faturë tatimore nr.15 datë 26.02.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx
20	Faturë tatimore nr.22 datë 09.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sha	xxxxxx

21	Faturë tatimore nr.01 datë 12.01.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Ujësjellës Kanalizime Durrës Sha	xxxxx
		xxxxx

Kontratë furnizimi me nr. 381/5 prot., datë 12.02.2021 me objekt “Shtypshkrime, tabelat e rezultateve dhe manual trajnime” lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor KQZ “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 6068/1 prot., datë 15.07.2021 lëshuar nga autoritetit kontraktor KQZ “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve” për kontratën me objekt “Shtypshkrime, tabelat e rezultateve dhe manual trajnime”.

Fatura tatimore

1	Faturë tatimore nr. 6 datë 10.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
2	Faturë tatimore nr. 9 datë 12.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
3	Faturë tatimore nr. 11 datë 19.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
4	Faturë tatimore nr. 13 datë 02.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
5	Faturë tatimore nr. 14 datë 08.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
6	Faturë tatimore nr. 15 datë 12.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
7	Faturë tatimore nr. 18 datë 13.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
8	Faturë tatimore nr. 22 datë 19.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
9	Faturë tatimore nr. 24 datë 20.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
10	Faturë tatimore nr. 25 datë 23.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
		xxxxx

Kontratë furnizimi me nr. 2748/5 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Procesverbale dorëzimi, etiketa dalluese për regjistrimin e votave, zarfa, bexhe” lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor

KQZ “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxxxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 942 prot., datë 18.02.2023 lëshuar nga autoritetit kontraktor KQZ “Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve” për kontratën me objekt “Procesverbale dorëzimi, etiketa dalluese për regjistrimin e votave, zarfa, bexhe”.

Fatura tatimore

1	Faturë tatimore nr. 17/2021 datë 12.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
2	Faturë tatimore nr. 20/2021 datë 15.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
3	Faturë tatimore nr. 26/2021 datë 23.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për KQZ	xxxxx
		xxxxx

1	Faturë tatimore nr. 143/2023 datë 19.07.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	xxxxx
2	Faturë tatimore nr. 167/2023 datë 22.09.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	xxxxx

Kontratë furnizimi me nr. 1524/51 prot., datë 06.01.2021 me objekt “Prodhimi i emisioneve të pullës për vitin 2020” lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Posta Shqiptare Sh.a” me operatorin ekonomik “Adel CO” SHPK me vlerë xxxxxxx lekë pa Tvsh.

Vërtetim realizimi me nr. 647/1 prot., datë 24.03.2022 lëshuar nga autoritetit kontraktor Posta Shqiptare Sh.A” për kontratën me objekt “Prodhimi i emisioneve të pullës për vitin 2020”.

Fatura tatimore nuk ka

- Fatura tatimore

	ADEL CO SHPK	ALL
	Përshkrimi i mallit/faturës	Vlera totale pa tvsh
1	Faturë tatimore nr. 204/2023 datë 17.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx
2	Faturë tatimore nr. 169/2023 datë 29.09.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx
3	Faturë tatimore nr. 205/2023 datë 20.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx
4	Faturë tatimore nr. 217/2023 datë 15.12.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx
5	Faturë tatimore nr. 177/2023 datë 16.10.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx
6	Faturë tatimore nr. 190/2023 datë 01.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxx

7	Faturë tatimore nr. 188/2023 datë 01.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
8	Faturë tatimore nr. 196/2023 datë 07.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
9	Faturë tatimore nr. 184/2023 datë 26.10.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
10	Faturë tatimore nr. 197/2023 datë 14.11.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
11	Faturë tatimore nr. 183/2023 datë 20.10.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
12	Faturë tatimore nr. 164/2023 datë 12.09.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
13	Faturë tatimore nr. 79/2023 datë 19.04.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
14	Faturë tatimore nr. 83/2023 datë 27.04.2023 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
15	Faturë tatimore nr. 10 datë 10.02.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
16	Faturë tatimore nr. 12 datë 12.02.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
17	Faturë tatimore nr. 14 datë 18.02.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
18	Faturë tatimore nr. 25 datë 11.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
19	Faturë tatimore nr. 31 datë 25.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
20	Faturë tatimore nr. 33 datë 01.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
21	Faturë tatimore nr. 35 datë 02.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
22	Faturë tatimore nr. 36 datë 06.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
23	Faturë tatimore nr. 2A datë 01.03.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
24	Faturë tatimore nr. 3A datë 06.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
25	Faturë tatimore nr.4A datë 06.04.2021 lëshuar nga Adel CO SHPK për Posta Shqiptare Sha	xxxxxx
		xxxxxx

III.4.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.4. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre

viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që " 2.3.a). *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet

të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.4.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues mbi mospërmbushjen e kriterit për vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në “kriteret e veçanta” të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.a) të dokumenteve të tenderit, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në lidhje me kontratat e ngjashme, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket vërtetimit të realizimit të furnizimeve të ngjashme.

Konkretisht, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre, si dhe përshkrimi i mallit të faturave tatimore të realizuara me ente publike, rezulton, se konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, sipas tabelës së përcaktuar në pikën III.4.2 të këtij vendimi. KPP pasi konstatoi, se këto kontrata dhe faturat tatimore zërat e të cilave mund të konsiderohen *furnizimet e mëparshme të ngjashme* me objektin e prokurimit, *të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate*, vëren se vlera e tyre prej X lekë, arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon, se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit *gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate*, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi të gjithë zërat e kontratave dhe faturave të paraqitura janë të ngjashme me objektin e prokurimit, plotësojnë vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë,

se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron furnizime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK mbi arsyet e skualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, pasi nuk përmbush kriterin 2.3.c: *“Ne kemi bindjen, që OE Adel Co shpk., në kundërshtim me pikën 2.3/c) “Kapacitetet teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrën “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST..... Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrës “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” të dorëzuar nga OE Adel Co shpk. nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrës së paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5, të DST...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në shtojcën 7, të dokumentave standarde të tenderit, në pikën 2.3.c) të kriterëve teknike, autoriteti kontraktor ka kërkuar:

c) *Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë mostra të mallrave objekt prokurimi - për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit.*

1. *Rulon me jo më pak se 200 pulla në rulon - 1(një) copë;*
2. *Shirit stampimi termik - 1(një) copë*
**të mjaftueshme për të realizuar stampimin e plotë të rulonit me 200 pulla;*
3. *Rulon kartoni mbledhës për pulla - 1(një) copë;*
4. *Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi - 1(një) copë.*

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat do të dorëzohen nga OE ofertues, në Zyrën e Protokollit të AKBPM, Kati i Parë, në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të futur në një zarf jo-transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e OE ofertues dhe me shënimin: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës: 21/2/2024, ora: 10.00”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kerkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.

III.5.2. Në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të dokumenteve stadarde të tenderit është kërkuar:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj;

Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

SPECIFIKIME TEKNIKE:

▪ **PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

***Përshkrimi:** pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.*

***Funksionimi:** Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.*

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

▪ **Etiketa**

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

▪ **Adezivi**

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

▪ **Letra mbajtëse ku vendosen pullat**

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 608C e sfumuar nga jashtë brenda.

Pulla do të përfshijë të stampuar:

g) Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.

h) Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.

i) Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit te ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave)

- **SHIRITA STAMPIMI TERMIK:**

Karakteristikat: Shiriti i printimit është i standartit universal ose **ekuivalent i tij**, i përshtatshëm për printim në letër me shtresë të shkëlqyeshme (gloss coated). Për printerat që disponojmë, shiriti termo-transfertë mund të jetë i ngjashëm me tipin ëax/resin.

Shiriti duhet të ketë: rezistencë të lartë kundrejt gërvishtjeve;

tretësve të ndryshëm;

veti stampuese shumë të mira.

Densiteti optik i shiritit 0.9 në transmetim

Densiteti optik (reflektimi) 1.70 në reflektim

Ambalazhi

Shirit i stampimit të jetë i mbledhur në rulona me gjatësi minimalisht 360 m dhe gjerësi 30 mm, diametër i brendshëm i unazës së kartonit të jetë 25mm, të përdorshëm për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termikë SQUIX**, të paketuara në kuti mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

- **RULONA KARTONI:**

- c) për mbledhjen e pullave, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 40mm, e përshtatshme për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termike SQUIX**;
- d) për mbledhjen e shiritave të printimit, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 25mm.

Ambalazhi

Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.


Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (kuti/kolia numrin e rulonave).


Modele ilustruese të pullës dhe aksesoreve për shtypjen e tyre (foto):



Model pulle



Pulla në rulon



Pulla në shirit



Shirita stampimi termik në rulon



Shirita stampimi termik



printimit

Rulon kartoni për mbledhjen e shiritit të



Rulon kartoni për mbledhjen e pullave

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kriterit për dorëzimin e mostrave nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Referuar procesverbalit të datës 28.02.2024 ora 10:00, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me administrimin e mostrave, operatori ekonomik “Adel Co” SHPK ka dorëzuar në zarf me nr. Prot., 485/20 datë 28.02.2024:

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.5.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.5.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.5.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.9. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.5.10. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të

përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”.

III.5.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.5.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Inpress” ShPK, konstatohet, se verifikimi i mostrave, nga Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, është bërë referuar specifikimeve teknike në këtë procedurë prokurimi. Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave ka hartuar Raport teknik me nr. 485/26 prot., të datës 07.03.2024, sipas së cilit është kualifikuar operatori ekonomik “Adel

Co” SHPK, për pëmbushje të specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara prej tij. Këtë vlerësim e ka dhënë Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimit teknik të tyre.

Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllimin e zbatimit të parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, duke u mbështetur në pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, kërkoi kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave *pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre* për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura të depozituar nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure prokurimi. Në kushtet, kur Komisioni nuk disponon pajisjet e duhura për një ekspertizë të tillë, iu drejtua me shkresat nr. 691/ 8 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/11 prot., datë 03.05.2024, Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to. Me shkresat nr. 691/ 9 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/12 prot., datë 03.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Laboratorit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to. Me shkresën nr. 375 prot., datë 06.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/13 prot., datë 09.05.2024, Laboratori EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, ka dërguar informacionin e kërkuar.

III.5.13. Pas konfirmimit të Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik 10.05.2024 mori vendimin nr. 477/2024 ku vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratori i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me fond limit: 26,299,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.*
- 2. Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni*

Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.

3. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.
4. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.
5. Në datën 14.05.2024 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.
6. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
7. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijeni e mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.5.14. Me shkresën me nr. 403 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/20 prot., datë 24.05.2024, me objekt “Raport - testimi” nga Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

- ❖ Raport Testimi Nr. 403 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.16	61.253	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	55	µm

Peshimi u krye me peshoren analitike elektronike KREN e tipit ABT 120-5DM e klasit të I. Kjo peshore është e kalibruar me anë të standardit ISO 45501 dhe në përputhje me rekomandimet e OIML, dhe R76-1 nga Laboratori i Masës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Marzhi i gabimit të vetë aparatit është 0.1g, gabim i pranueshëm. Kushtet e mjedisit gjatë kryerjes së peshimit janë normale, me temperaturë 21°C, lagështu rekatve 51% dhe presion atmosferik 14.731psi. Mostra e parë e peshuar është e tipit etiketë e cila u

shkëput mnga letra mbajtëse dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5 cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqia totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pësha mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02931g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si më poshtë:

Masa në m²=M/Sx10000

Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;

S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².

Bazuar në formulën e sipërme përmendur masa letër është 78.16 g/m².

Mostra e dytë e peshuar është e tipit letër mbajtëse e etiketës e cila u shkëput nga etiketa dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqia totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pësha mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02297g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si mëposhtë:

Masa në m²=M/Sx10000

Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;

S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².

Bazuar në formulën e sipërme përmendur masa letër është 61.253 g/m².

III.5.15. Referuar sa më sipër, Komisioni i prokurimit Publik vëren, se në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi rezulton se:

- **PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

Përshkrimi: pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

- **Etiketa**

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pësha 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

▪ **Adezivi**

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

▪ **Letra mbajtëse ku vendosen pullat**

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. *I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 608C e sfumuar nga jashtë brenda.*

Pulla do të përfshijë të stampuar:

- j) *Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.*
- k) *Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.*
- l) *Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.*

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- *Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacistë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.*
- *Në pjesën e sipërme, nën shkrimin MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.*
- *Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.*
- *Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.*

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit të ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave).

Ndërkohë nga raport testimet e paraqitura të kryera nga laboratorit i akredituar Laboratorit “Eko-Studio Projekt” SHPK, rezultoi se mostra , “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori” e paraqitur nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK në datën dhe orën e zhvillimit për këtë procedurë prokurimi, ka rezultuar me të dhënat teknike si më poshtë:

- ❖ *Raport Testimi Nr. 403 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ADEL CO” SHPK.*

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.16	61.253	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	55	µm

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me të drejtë ka kualifikuar operatorin ekonomik “Adel Co” ShPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht, të gjithë komponentët e kërkuar të testuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcën nr.5 “Specifikimet teknike” për “*Etiketa për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Për më tepër, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka patur reklamim nga përfaqësuesit e palëve prezente të operatorëve ekonomikë apo autoritetit kontraktor, mbi mostrën, për të cilën do të kryhej ekspertiza e kërkuar në laborator të akredituar nga ana e Komisionit. Gjithashtu, Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar raportit të testimit të kryer nga laborator i akredituar, gjykon se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Adel Co” ShPK, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” ShPK, nuk qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK mbi arsyet e skualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, pasi nuk përmbush kriterin 2.3.b): “...OE Adel Co shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3./b) “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur dokumentacionin ligjor dhe teknik ”...autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për secilin dhe të gjithë artikujt / mallrat e ofertuar, në origjinal ose kopje të përkthyer dhe njesuar me origjinalin. Gjithashtu, bazuar në formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit ligjor dhe teknik të paraqitur nga OE Adel Co shpk. NUK vërtetohet lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar për secilin dhe të gjithë artikujt / mallrat me OE pjesëmarrës Adel Co shpk. Rrjedhimisht, në zbatim të pikës 2.3./b) “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, OE Adel Co shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi dokumentacioni ligjor dhe teknik i paraqitur nga ky operator ekonomik nuk vërteton lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe / ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi me OE pjesëmarrës Adel Co shpk. Për sa më sipër, OE Adel Co

shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3./b) "Kapaciteti Teknik", të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7, për pika 2.3.b "Kapaciteti teknik", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*" b) Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi (në rast se nuk është prodhues i miërfilltë) duhet të paraqesë **Autorizim nga Prodhuesi** ose nga **Distributori Zyrtar i Autorizuar nga Prodhuesi**. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.*

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, ne se lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetin Kontraktor.

Shënim: *Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".*

III.6.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik "ADEL CO" SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Autorizim Prodhuesi (të njësuara me origjinalin dhe të përkthyer) datë 16.02.2024 lëshuar nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H me përmbajtje si më poshtë vijon: *"Nëpërmjet kësaj, Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me numër regjistri të kompanisë FN89306h) prodhues të mirënjohur dhe prestigjioz të etiketave, biletave, pullave dhe produkteve të printuara të sigurisë të Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me fabrika në Betriebsstrasse 3, A-2011 Höbersdorf, Austri, autorizon Adel Co shpk për të paraqitur një ofertë, dhe më pas për të negociuar dhe nënshkruar kontratën me institucionin tuaj sipas Specifikimeve Teknike në Dokumentet e Tenderit "Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre" Nr. Reference 94529-02-05-2024 për mallrat/lëndën e parë të mësipërme të prodhuara nga ne. Ne japim garancinë tonë të plotë se do të prodhojmë dhe furnizojmë Adel Co shpk me mallrat siç përshkruhet në specifikimet teknike të kushteve të kontratës për mallrat e ofruara për furnizim nga firma e mësipërme ndaj kësaj ftese për ofertë.*

III.6.3. Në nenin 2 "Qëllimi" të ligjit nr.162/2022 "Për Prokurimin Publik" parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.6.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.6.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.6.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.6.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me

dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.6.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregtimin e artikujve të ofruar (Dokumentet duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara). Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, origjinal/fotokopje e noterizuar, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi si: telefon, fax, e-mail, website, nëse lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetin Kontraktor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur ndër të tjera edhe Autorizim Prodhuesi (të njëshuar me origjinalin me Nr. Rep 638 datë 19.02.2024 dhe të përkthyer dhe noterizuar me Nr. Rep 637 datë 19.02.2024) datë 16.02.2024, lëshuar nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, i nënshkruar dhe i vulosur me përmbajtje si më poshtë vijon: *“Nëpërmjet kësaj, Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me numër regjistri të kompanisë FN89306h) prodhues të mirënjohur dhe prestigjioz të etiketave, biletave, pullave dhe produkteve të printuara të sigurisë të Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, me fabrika në Betriebsstrasse 3, A-2011 Höbersdorf, Austri, autorizon Adel Co shpk për të paraqitur një ofertë, dhe më pas për të negociuar dhe nënshkruar kontratën me institucionin tuaj sipas Specifikimeve Teknike në Dokumentet e Tenderit “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre” Nr. Reference 94529-02-05-2024 për mallrat/lëndën e parë të mësipërme të prodhuara nga ne. Ne japim garancinë tonë të plotë se do të prodhojmë dhe furnizojmë Adel Co shpk me mallrat siç përshkruhet në specifikimet teknike të kushteve të kontratës për mallrat e ofruara për furnizim nga firma e mësipërme ndaj kësaj ftese për ofertë”.*

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentin me emërtim autorizim prodhuesi lëshuar më datë 16.02.2024 nga Ulrich Etiketten Ges.m.b.H, ku pasqyrohet kompania prodhuese dhe të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, në se lind nevoja për verifikim nga ana e Autoritetit Kontraktor. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Adel Co” SHPK, me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.b të kriteve të veçanta të kualifikimit “kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Inpress” ShPK nuk qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK mbi arsyet e skualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, pasi

nuk përmbush kriterin 2.3.b): “.....Operatori ekonomik Albdesign PSP shpk. nuk e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetdeklarimit në pikën ku citon “Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. ” për të cilën duhet të përcaktonte se adresa e ueb-it është www.app.gov.al dhe Autoriteti ose organi lëshues që është Buletini i Agjencisë së Prokurimit Publik. ... Referuar sa më sipër, operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi NUK ka paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit duke mos dhënë të dhëna që ky formular parashikon”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- --
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim

është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësimin e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë

konkurent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III,

Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ <u>Makineri e mjete</u>

	Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.7.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Formular Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

III.7.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga*

gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji; c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën; d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja; e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo

të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. 4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni. 5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.7.4. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për

kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.7.5 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.7.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në

fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.7.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e

kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin konkret Komisioni konstaton, se operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit. Në këtë formular vetdeklarimi, shtojca 8 e DST, pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, pika “A” deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pika ku citohet: *“Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës”, dhe “Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi”,* operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka dhënë të dhëna në fjalinë ku është cituar se *“Sqarime nëse është e nevojshme:.....Agjencia e Prokurimit Publik, Njoftime dhe/ose Buletini”*. Komisioni gjykon, se operatori ekonomik e ka plotësuar formularin përmbledhës të vetdeklarimit në pikën ku citon *“Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së....”* për të cilën ka përcaktuar se adresa e ueb-it është www.app.gov.al dhe Autoriteti ose organi lëshues që është Buletini i Agjencisë së Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me udhëzimet dhe kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, duke dhënë të dhëna që ky formular parashikon. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” SHPK nuk qëndron.

III.8. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK mbi arsyet e skualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, pasi nuk përmbush kriterin 2.3.a.) *“...Nisur nga njohja e mirë që OE Inpress shpk ka në tregun*

shqiptar që përfshin edhe objektin e prokurimit konkret, dhe secilit prej mallrave / artikujve të kërkuar në DST, mendojmë që OE Albdesign PSP shpk. nuk ploteson kriterin mësipër për punë / furnizime të mëparshme të ngjashme, pasi: NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP punë / furnizime të ngjashme në total në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh (40% të fondit limit), dhe në proporcion me ofertën e paraqitur prej tij për zërat e secilit prej artikujve / mallrave (40% të fondit limit për secilin nga mallrat / artikujt) të kërkuara në DST; NUK ka paraqitur në sistemin SPE të APP dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar nga DST dhe sipas përcaktimeve të specifikuara në DST, për të vërtetuar realizimin e punëve të ngjashme (në vlerën 10,519,600 (dhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh), dhe në proporcion me ofertën e paraqitur prej tij për artikujt / mallrat, e kërkuar në këtë procedurë prokuruese. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 2 modifikohet kriteri 2.3.a), “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.a) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë: Shtojca 7 e DST “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të “2. Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”:

Ishte:

2.3 Kapaciteti teknik:

b) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Bëhet:

2.4 Kapaciteti teknik:

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

III.8.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

	ALBDESIGH PSP SHPK	ALL
	Përshkrimi i mallit/faturës	Vlera totale pa tvsh
1	Faturë tatimore nr. 14/2022 datë 10.01.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	xxxxxx
2	Faturë tatimore nr. 118/2022 datë 15.02.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	xxxxxx
3	Faturë tatimore nr. 127/2022 datë 18.02.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	xxxxxx

4	Faturë tatimore nr. 130/2022 datë 19.02.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
5	Faturë tatimore nr. 151/2022 datë 24.02.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
6	Faturë tatimore nr. 204/2022 datë 10.03.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
7	Faturë tatimore nr. 273/2022 datë 30.03.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
8	Faturë tatimore nr. 380/2022 datë 03.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
9	Faturë tatimore nr. 391/2022 datë 07.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
10	Faturë tatimore nr. 429/2022 datë 17.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
11	Faturë tatimore nr. 438/2022 datë 18.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
12	Faturë tatimore nr. 472/2022 datë 27.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
13	Faturë tatimore nr. 485/2022 datë 31.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
14	Faturë tatimore nr. 522/2022 datë 08.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
15	Faturë tatimore nr. 542/2022 datë 14.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
16	Faturë tatimore nr. 570/2022 datë 17.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
17	Faturë tatimore nr. 585/2022 datë 21.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
18	Faturë tatimore nr. 590/2022 datë 22.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
19	Faturë tatimore nr. 615/2022 datë 29.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
20	Faturë tatimore nr. 630/2022 datë 04.07.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
21	Faturë tatimore nr. 660/2022 datë 13.07.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
22	Faturë tatimore nr. 809/2022 datë 25.08.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
23	Faturë tatimore nr. 819/2022 datë 29.08.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
24	Faturë tatimore nr. 820/2022 datë 29.08.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX

25	Faturë tatimore nr. 853/2022 datë 02.09.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
26	Faturë tatimore nr. 924/2022 datë 29.09.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
27	Faturë tatimore nr. 925/2022 datë 29.09.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
28	Faturë tatimore nr. 939/2022 datë 04.10.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
29	Faturë tatimore nr. 964/2022 datë 11.10.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
30	Faturë tatimore nr. 979/2022 datë 17.10.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
31	Faturë tatimore nr. 1043/2022 datë 01.11.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
32	Faturë tatimore nr. 1062/2022 datë 07.11.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
33	Faturë tatimore nr. 1165/2022 datë 15.12.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
34	Faturë tatimore nr. 1201/2022 datë 23.12.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
35	Faturë tatimore nr. 1210/2022 datë 28.12.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
36	Faturë tatimore nr. 318/2022 datë 12.04.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
37	Faturë tatimore nr. 330/2022 datë 15.04.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
38	Faturë tatimore nr. 359/2022 datë 25.04.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
39	Faturë tatimore nr. 370/2022 datë 29.04.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
40	Faturë tatimore nr. 2/2023 datë 05.01.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
41	Faturë tatimore nr. 52/2023 datë 25.01.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
42	Faturë tatimore nr. 78/2023 datë 03.02.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
43	Faturë tatimore nr. 208/2023 datë 13.03.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
44	Faturë tatimore nr. 242/2023 datë 20.03.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
45	Faturë tatimore nr. 388/2023 datë 03.05.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
46	Faturë tatimore nr. 389/2023 datë 03.05.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX

47	Faturë tatimore nr. 472/2023 datë 25.05.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
48	Faturë tatimore nr. 536/2023 datë 16.06.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
49	Faturë tatimore nr. 681/2023 datë 02.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
50	Faturë tatimore nr. 706/2023 datë 15.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
51	Faturë tatimore nr. 707/2023 datë 15.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
52	Faturë tatimore nr. 708/2023 datë 15.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
53	Faturë tatimore nr. 709/2023 datë 15.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
54	Faturë tatimore nr. 717/2023 datë 18.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
55	Faturë tatimore nr. 851/2023 datë 10.10.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
56	Faturë tatimore nr. 899/2023 datë 31.10.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
57	Faturë tatimore nr. 900/2023 datë 31.10.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
58	Faturë tatimore nr. 971/2023 datë 29.11.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
59	Faturë tatimore nr. 1019/2023 datë 13.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
60	Faturë tatimore nr. 1084/2023 datë 29.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
61	Faturë tatimore nr. 1085/2023 datë 29.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për HAKO SHPK	XXXXXX
62	Faturë tatimore nr. 412/2022 datë 12.05.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për NOVAL Diagnostic SHPK	XXXXXX
63	Faturë tatimore nr. 949/2022 datë 06.10.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për ALGRAFIKA SHPK	XXXXXX
64	Faturë tatimore nr. 263/2022 datë 29.03.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA	XXXXXX
65	Faturë tatimore nr. 562/2022 datë 17.06.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për Banka OTP Albania	XXXXXX
66	Faturë tatimore nr. 598/2023 datë 04.07.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për TENIUS LABORATORIES	XXXXXX
67	Faturë tatimore nr. 1154/2022 datë 09.12.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për ALB.AMERIC.FOUND Dega Shqipëri	XXXXXX

68	Faturë tatimore nr. 230/2022 datë 19.03.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për Textile Service Italia	XXXXXX
69	Faturë tatimore nr.309/2022 datë 08.04.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për Textile Service Italia	XXXXXX
70	Faturë tatimore nr. 618/2023 datë 12.07.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
71	Faturë tatimore nr. 741/2023 datë 31.08.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
72	Faturë tatimore nr. 959/2023 datë 24.11.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
73	Faturë tatimore nr. 963/2023 datë 24.11.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
74	Faturë tatimore nr. 1010/2023 datë 09.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
75	Faturë tatimore nr. 1068/2023 datë 26.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
76	Faturë tatimore nr. 19/2024 datë 11.01.2024 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për FLORFARMA	XXXXXX
77	Faturë tatimore nr. 90/2024 datë 01.02.2024 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për FLORFARMA	XXXXXX
78	Faturë tatimore nr. 114/2024 datë 06.02.2024 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për VIBIA	XXXXXX
79	Faturë tatimore nr. 947/2023 datë 21.11.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për FLORFARMA	XXXXXX
80	Faturë tatimore nr. 459/2023 datë 06.06.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA	XXXXXX
81	Faturë tatimore nr. 616/2023 datë 12.07.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për RAIFFEISEN BANK SH.A.	XXXXXX
82	Faturë tatimore nr. 1008/2023 datë 08.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për RAIFFEISEN BANK SH.A.	XXXXXX
83	Faturë tatimore nr. 1080/2023 datë 29.12.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për RAIFFEISEN BANK SH.A.	XXXXXX
84	Faturë tatimore nr. 1218/2022 datë 28.12.2022 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për RAIFFEISEN BANK SH.A.	XXXXXX

85	Faturë tatimore nr. 786/2023 datë 20.09.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për Stone Castle Vineyards & ëinery	XXXXXX
86	Faturë tatimore nr. 855/2023 datë 13.10.2023 lëshuar nga ALBDESIGH PSP SHPK për Stone Castle Vineyards & ëinery	XXXXXX

III.8.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.8.4. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje me

dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:
4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.8.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që ” 2.3.a). *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.8.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik, që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.8.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme, ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.8.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e të operatorit ekonomik ankimues mbi mospërmbushjen e kriterit për vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në "kriteret e veçanta" të kualifikimit, "kapaciteti teknik" pika 2.3.a) të dokumenteve të tenderit, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPK në lidhje me kontratat e ngjashme, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket vërtetimit të realizimit të furnizimeve të ngjashme.

Konkretisht, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i mallit të faturave tatimore të realizuara me subjekte private, rezulton se vetëm një pjesë e tyre mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, sipas tabelës së përcaktuar në pikën III.8.2 të këtij vendimi. KPP pasi i veçoi këto kontrata dhe faturat tatimore zërat e të cilave mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, vëren se vlera e tyre prej **X lekë** arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "Albdesign PSP" SHPK, me dokumentacionin e paraqitur provon, se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e

prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi jo të gjithë zërat e kontratave dhe faturave të paraqitura janë të ngjashme me objektin e prokurimit, si dhe ato zëra të kontratave apo faturave që KPP i konsideroi si të ngjashëm me objektin e prokurimit mjaftojnë për të plotësuar vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron furnizimet e mëparshme të ngjashme të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik “Albdesign PSP” SHPK.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndron.

III.9. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK mbi arsyet e skualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Albdesign PSP” SHPK, pasi nuk përmbush kriterin 2.3. c): *“Ne kemi bindjen, që OE Albdesign PSP shpk., në kundërshtim me pikën 2.3/c) iKapacitetet teknik”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, nuk ka paraqitur mostrën “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST... Në lidhje me këtë kriter kualifikues, ne kemi bindjen që mostra “Pulla Kontrolli me Elementë Sigurie” e paraqitur nga OE Albdesign PSP shpk., NUK është në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara dhe të kërkuara në Shtojcën 7 iKriteret e vecanta të kualifikimit” - iKapaciteti teknik”, pika 2.3.6, të DST, përrsa i përket:*

- i. *Peshës së Etiketës të mostrave të dorëzuara;*
- ii. *Spesorit të Etiketës të mostrave të dorëzuara;*
- iii. *Peshës së Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara;*
- iv. *Spesorit të Letrës mbajtëse ku vendosen pullat të mostrave të dorëzuara.*

Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe Komisioni i Prokurimit Publik, që të ndërmerren procedurat e nevojshme verifikuese të testimit të mostrave të dorëzuara nga OE Albdesign PSP shpk. nga Laboratorë të Akredituar në Republikën e Shqipërisë, për verifikimin e përpuethshmërisë së mostrave të paraqitura nga ky operator ekonomik me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5, të DST.

Rrjedhimisht, OE Albdesign PSP shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3.c) “Kapaciteti teknik”, të

shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi NUK ka paraqitur mostrat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në DST. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në shtojcën 7, të dokumenteve standarde të tenderit, në pikën 2.3.c) të kriterëve teknike autoriteti kontraktor ka kërkuar:

c) *Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë mostra të mallrave objekt prokurimi - për secilin nga artikujt e listës, sipas specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit.*

1. *Rulon me jo më pak se 200 pulla në rulon - 1(një) copë;*
2. *Shirit stampimi termik - 1(një) copë*
**të mjaftueshme për të realizuar stampimin e plotë të rulonit me 200 pulla;*
3. *Rulon kartoni mbledhës për pulla - 1(një) copë;*
4. *Rulon kartoni mbledhës për shirit printimi - 1(një) copë.*

Autoriteti Kontraktor kërkon mostra të mallrave që do të prokurohen, pasi gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat e mallrave do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë ekskluzivisht në kontroll të Autoritetit Kontraktor.

Mostrat do të dorëzohen nga OE ofertues, në Zyrën e Protokollit të AKBPM, Kati i Parë, në adresën: Rruga e Dibrës, Nr.359/1, Tiranë, të futur në një zarf jo-transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e OE ofertues dhe me shënimin: “Ofertë për furnizimin e “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, Nr e Njoftimit, “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA datës: 21/2/2024, ora: 10.00”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Mos paraqitja e këtyre kampioneve apo mospërputhshmëria e tyre me specifikimet teknike të kerkuara në DST, në përfundim të fazës së vlerësimit teknik, përbën kusht skualifikimi.

III.9.2. Në shtojcën 5 të specifikimeve teknike të dokumenteve standarde të tenderit është kërkuar:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë

ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj;

Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

SPECIFIKIME TEKNIKE:

▪ **PULLA KONTROLLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

Përshkrimi: pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

▪ **Etiketa**

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

▪ **Adezivi**

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

▪ **Letra mbajtëse ku vendosen pullat**

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 608C e sfumuar nga jashtë brenda.

Pulla do të përfshijë të stampuar:

- m) Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin *MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE* me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- n) Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin *AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE* me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- o) Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin *MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE*, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin *AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE*, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrë të përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit të ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave)

▪ SHIRITA STAMPIMI TERMIK:

Karakteristikat: Shiriti i printimit është i standartit universal ose **ekuivalent i tij**, i përshtatshëm për printim në letër me shtresë të shkëlqyeshme (gloss coated). Për printerat që disponojmë, shiriti termo-transfertë mund të jetë i ngjashëm me tipin ëax/resin.

Shiriti duhet të ketë: rezistencë të lartë kundrejt gërvishtjeve;

tretësve të ndryshëm;

veti stampuese shumë të mira.

Densiteti optik i shiritit 0.9 në transmetim

Densiteti optik (reflektimi) 1.70 në reflektim

Ambalazhi

Shirit i stampimit të jetë i mbledhur në rulona me gjatësi minimalisht 360 m dhe gjerësi 30 mm, diametër i brendshëm i unazës së kartonit të jetë 25mm, të përdorshëm për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termikë SQUIX**, të paketuara në kuti mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.

▪ RULONA KARTONI:

e) për mbledhjen e pullave, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 40mm, e përshtatshme për pajisjet e printimit të tipit **Printer me transfertë termikë SQUIX**;

f) për mbledhjen e shiritave të printimit, me gjerësi 30 mm, diametër të brendshëm të unazës së kartonit 25mm.

Ambalazhi

Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm.


Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për çdo njësi ambalazhi (kuti/kolia numrin e rulonave).


Modele ilustruese të pullës dhe aksesorëve për shtypjen e tyre (foto):



Model pulle



Pulla në rulon



Pulla në shirit



Shirita stampimi termik në rulon



Shirita stampimi termik



printimit

Rulon kartoni për mbledhjen e shiritit të



Rulon kartoni për mbledhjen e pullave

III.9.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kriterit për dorëzimin e mostrave nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Referuar procesverbalit të datës 28.02.2024, ora 10:00, të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me administrimin e mostrave, operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK ka dorëzuar në zarfën me nr. Prot., 485/19 datë 28.02.2024:

III.9.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjt operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.9.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.9.6. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve,

duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.9.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.9.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.9.9. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr. 285 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

III.9.10. Në nenin 36, “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor".

III.9.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.9.12. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë KPP, si dhe bazuar në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” ShPK, konstatohet, se verifikimi i mostrave, nga Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, është bërë referuar specifikimeve teknike në këtë procedurë prokurimi. Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave ka hartuar Raport teknik me nr. 485/26 prot., të datës 07.03.2024, sipas të cilit është kualifikuar operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” ShPK, për pëmbushje të specifikimeve teknike të mostrave të dorëzuara prej tij. Këtë vlerësim e ka dhënë Komisioni i Vlerësimit Të Ofertave, duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimit teknik të tyre.

Për këtë arsye, Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllimin e zbatimit të parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, duke u mbështetur në pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, kërkoi kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave *pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesore për shtypjen e tyre* për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura të depozituar nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” ShPK, në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure prokurimi. Në kushtet, kur Komisioni nuk disponon pajisjet e duhura për një ekspertizë të tillë, iu drejtua me shkresat nr. 691/ 8 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/11 prot., datë 03.05.2024, Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe

aksesorë për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to. Me shkresat nr. 691/ 9 prot., datë 24.04.2024 dhe me nr. 691/12 prot., datë 03.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Laboratorit “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, nëse ju si subjekt dispononi një laborator të certifikuar dhe akredituar që realizon matje dhe peshime të pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre, apo të ngjashme me to.

Me shkresën nr. 375 prot., datë 06.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/13 prot., datë 09.05.2024, Laboratori EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, dërgoi informacionin e kërkuar.

III.9.13. Pas konfirmimit të Laboratorit EKO-STUDIO-PROJEKT SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik 10.05.2024 mori vendimin nr. 477/2024 ku vendosi:

- 1. Të urdhërojnë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrave pullave të kontrollit me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Adel CO” SHPK dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nga laboratori i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostrat e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesorë për shtypjen e tyre”, me fond limit: 26,299,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 28.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.*
- 2. Operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.*
- 3. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “Adel CO” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.*
- 4. Operatori ekonomik “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 18,512 lekë pa tvsh për testimin e mostrave të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 375 prot., datë 06.05.2024 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 14.05.2024 ora 11:00.*
- 5. Në datën 14.05.2024 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve*

Mjekësore dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Adel Co” SHPK, “Inpress” SHPK, dhe “ALBDESIGN PSP” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.

6. Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
 7. Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK të kryejë testimin e mostrave dhe të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve pune nga marrja dijani e mostrave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.9.14. Me shkresën me nr. 402 prot., datë 21.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 691/19 prot., datë 24.05.2024, me objekt “Raport - testimi” nga Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

- ❖ Raport - Testimi Nr. 402 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.560	61.547	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	56	µm

Peshimi u krye me peshoren analitike elektronike KREN e tipit ABT 120-5DM e klasit të I. Kjo peshore është e kalibruar me anë të standardit ISO 45501 dhe në përputhje me rekomandimet e OIML, dhe R76-1 nga Laboratori i Masës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Marzhi i gabimit të vetë aparatit është 0.1g, gabim i pranueshëm. Kushtet e mjedisit gjatë kryerjes së peshimit janë normale, me temperaturë 21°C, lagështi rekatve 51% dhe presion atmosferik 14.731psi. Mostra e parë e peshuar është e tipit etiketë e cila u shkëput nga letra mbajtëse dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5 cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqja totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pesha mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02931g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si më poshtë:

$$\text{Masa në m}^2 = M/S \times 10000$$

Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;

S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².

Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa letër është 78.560 g/m².

Mostra e dytë e peshuar është e tipit letër mbajtëse e etiketës, e cila u shkëput nga etiketa dhe u pre me përmasa: gjatësi 2.5cm dhe gjersi 1.5 cm. Sipërfaqja totale e letrës së peshuar është 3.75 cm². Pesha mesatare e etiketës për sipërfaqen e peshuar është 0.02297g. Për gjetjen e masës së letrës të të njëjtit tip për sipërfaqen 1m² na shërben formula si më poshtë:

$$\text{Masa në m}^2 = M/S \times 10000$$

*Ku: M-është masa e peshuar e letrës në g;
S-është sipërfaqia e letrës së peshuar në cm².*

Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa letër është 61.547 g/m².

III.9.15. Referuar sa më sipër, Komisioni i prokurimit Publik vëren, se në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi rezulton se:

- **PULLA KONTROLI ME ELEMENTË SIGURIE:**

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi:

Skicimet, parametrat teknik etj; Specifikimi i Materialeve; Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to janë si më poshtë vijon:

1- Artikulli: Pulla kontrolli me elementë sigurie për barna.

Përshkrimi: pullat duhet të jenë të ndara nga njëra tjetra, të vendosura në qendër, distanca midis tyre 3 mm, të ngjitura në rulon letër.

Funksionimi: Prodhimi i pullave do të bëhet në rulon që lejon përdorimin e makinave automatike dhe manuale.

Përmasat-Dimensionet e etiketës janë 25 x 14.5 mm, me cepa të rrumbullakosura.

Karakteristika të materialit përbërës:

- ***Etiketa***

Letër e bardhë pa dru e patinuar nga njëra anë me llustër. Letra të ketë sipërfaqe të shkëlqyeshme e përshtatshme për shtypje me shumë ngjyra, me precizion.

Pesha 78 gr/m²

Spesori 68 mikron

Bardhësia 90%

Opaciteti 90%

Shkëlqyeshmëria 84%

Këputja në drejtim MD e CD 8-4 kg/15 mm

- ***Adezivi***

Nga prapa pulla të ketë adeziv të qëndrueshëm akrilik i përshtatshëm për një gamë të gjerë të etiketave të natyrës që kërkojmë (pulla) dhe i aplikueshëm për ndryshime të mëdha të temperaturës.

Ngjitja të jetë e fortë/permanente ku në 60 minuta pas ngjitjes të jetë e pashqitshme.

Qëndrueshmëria e këputjes të jetë 480m.

Koha e aftësisë ngjitëse 1 orë minimal

Temperatura e aplikimit +5 °C

Variacion temperature në përdorim -20 deri në +80 °C

- ***Letra mbajtëse ku vendosen pullat***

Letër super kalandruar monosilikon

Pesha 61 gr/m²

Spesori 55 mikron

Transparenca 49 %

Qëndrueshmëria në këputje 80 deri në 40 N/15 mm

Përshkrimi:

I. I gjithë sfondi i etiketës duhet të jetë me një motiv (tip filigrane mijëra pikëshe), shtypur me ngjyrë Pantone 608C e sfumuar nga jashtë brenda.

Pulla do të përfshijë të stampuar:

- p) Në krye të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE** me dimension 20 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- q) Në fund të saj, në sfond të shkrimit duhet të ketë: një motiv tip filigrane me valëzim me dimension 25 mm x 3 mm, me bojë UV me ngjyrë Blu Reflex e sfumuar në drejtim vertikal, si dhe shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE** me dimension 24 mm x 1 mm, me karakter Times Neë Roman (kapitale), të qendëruara, shtypur mbi motivin e valëve, me ngjyrë Blu Reflex.
- r) Në krahun e majtë të pullës në mënyrë vertikale do të vendoset një numër 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje. Numri do të jetë me ngjyrë të zezë, lloji i shkrimit të numrit Times Neë Roman, gjerësia e numrit 1.2 mm dhe gjatësia 8 mm. Sipërfaqja duhet të jetë e patinuar nga njëra anë me llustër”, sqarojmë se numri serial duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv nga 00000001 e në rritje, pra numri fillestar duhet të jetë 8 (tetë) shifror progresiv e më pas vazhdon në rritje.

Për rrjedhojë mostrat që do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor duhet të jenë me numër serial 8 (tetë) shifror.

II. Elementë sigurie:

- Në dy cepa të etiketës me koordinata: 1,5 mm x 11,5 mm dhe 23,5 mm x 11,5 mm, duhet të ketë dy elemente sigurie (stema e farmacisë gjarpër në gotë), me dimension 2 mm x 2 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshon ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e sipërme, nën shkrimin **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Në pjesën e poshtme, mbi shkrimin **AGJENCIA KOMBËTARE E BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE**, duhet të ketë elementë sigurie në formë drejtkëndëshi me dimension 20 mm x 1 mm, shtypur me bojë të tejdukshme që fluoroshojnë ngjyrë të verdhë nën dritën e llampës ultravioletë.
- Midis dy motiveve poshtë e lart, duhet të ketë një hapësirë bosh (sfond) me bojë UV me ngjyrën e përcaktuar si në pikën 1, prej 8mm, e mjaftueshme për të shtypur tekstin, me letër termo transfertë.

Ambalazhi

Pullat duhet të jenë në rulon me përmasa: 40mm diametri i brendshëm dhe jo më e madhe se 200mm diametri i jashtëm; duhet të ketë në fund të shiritit të ngjitur në mënyrë të sigurt etiketën specifikuese, për sasinë e pullave në rulon. Të jenë të paketuara dhe të ambalazuara në kuti, në mënyrë të tillë që të jetë e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen nga faktorë të jashtëm. Kutia nuk duhet të peshojë më shumë se 25 kg.

Etiketimi

Do të përfshijë në shqip sasinë për cdo njësi ambalazhi (ruloni numrin e pullave, kuti/kolia numrin e rulonave).

Ndërkohë nga raport - testimet e paraqitura, të kryera nga laborator i akredituar Laboratori “Eko-Studio Projekt” SHPK, rezultoi, se mostra “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” ShPK në datën dhe orën e zhvillimit për këtë procedurë prokurimi, ka rezultuar me të dhënat teknike si më poshtë:

- ❖ Raport - Testimi Nr. 402 dt.21.05.2024, “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK.

Nr.	Komponent të matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1	Gramatura	ISO 536:2019	78.560	61.547	g/m ²
2	Trashësia	ISO 534:2005	68	56	µm

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor me të drejtë ka kualifikuar operatorin ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht, të gjithë komponentët e kërkuar të testuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcën nr.5 “Specifikimet teknike” për “Etiketa” për specifikimet peshën dhe spesori, “Letra mbajtëse ku vendosen pullat” për specifikimet peshën dhe spesori”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Për më tepër, gjatë seancës dëgjimore, nuk ka pasur reklamim nga përfaqësuesit e palëve prezente të operatorëve ekonomikë apo autoritetit kontraktor, mbi mostrën, për të cilën do të kryhej ekspertiza e kërkuar në laborator të akredituar nga ana e Komisionit. Gjithashtu, Komisioni thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni referuar raportit të testimet të kryer nga laborator i akredituar, gjykon, se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik

“ALBDESIGN PSP” SHPK, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” ShPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94529-02-05-2024, me objekt: “Blerje pulla kontrolli me elementë sigurie për barnat, dhe aksesori për shtypjen e tyre”, me fond limit: **26,299,000** (njëzet e gjashtë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 28.02.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INPRESS” SHPK për procedurën e prokurimit, objekt - ankimi.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBDESIGN PSP” SHPK.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INPRESS” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
	Kryetar		
	Jonaid Myzyri		